



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 07.12.2021)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Apelit, për një pozicion të lirë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 14:26.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
11. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 4. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 5. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Apelit, për një pozicion të lirë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

*Naureda Llagami:* Viojmë mbledhjen me çështjet sipas rendit të ditës. Kalojmë tek çështja e radhës që ka të bëjë me hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Apelit, për një pozicion të lirë. Projekt-akti është bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe do të raportohet nga zoti Toska.

*Ilir Toska:* Faleminderit!

Siç parashtrori edhe Kryetarja, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ju ka sjellë si propozim projektvendimin “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Apelit, për një pozicion të lirë”. Krahas projektvendimit ju është përcjellë edhe relacioni shpjegues. Shkurtimisht mund t’ju parashtroj:

Sipas Dekreti të Presidentit të Republikës nr.7818 datë 16.11.2012, i ndryshuar, organika e Gjykatës Administrative të Apelit është 13 (trembëdhjetë) gjyqtarë, numër ky i gjyqtarëve që vijon të jetë ende në fuqi, ndërsa Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk ka marrë ende një vendim për numrin e gjyqtarëve për gjykatë, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, sikurse kjo përcaktohet në nenin 90 të tij.

Aktualisht në Gjykatën Administrative të Apelit kanë caktimin e përhershëm 10 (dhjetë) gjyqtarë, nga të cilët ushtrojnë detyrën vetëm 5 (pesë) prej tyre, ndërsa 5 (pesë)

gjqtarët e tjerë janë të pezulluar nga detyra “ex lege”, sipas Ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për shkak se janë shkarkuar nga detyra me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Sa i përket 5 (pesë) pozicioneve të lira të përkohshme në Gjykatën Administrative të Apelit, ato nuk mund të plotësohen përmes procedurës së lëvizjes paralele dhe asaj të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve. Sipas neneve 43 dhe 48 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë e gjyqtarëve bëhet për një pozicion të lirë të përhershëm. Përgjithësisht, ligji, neni 43, pika 12, shkronja “ç”, e Ligjit për Statusin, përcakton se: “12. Këshillat miratojnë rregulla më të detajuara, të cilat përcaktojnë: ...; ç) zbatimin dhe përshtatjen e këtij neni për pozicionet e lira të përkohshme”. Këshilli ka miratuar Vendimin nr.320 datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele”, sipas të cilit, rregullat sipas tij zbatohen për pozicionet e lira të përhershme dhe për ato që pritet të bëhen të tilla brenda 3 muajve, si dhe, për aq sa është e mundur, edhe për pozicionet e lira të përkohshme (pika 3), por se, lëvizja paralele në Gjykatën Administrative të Apelit është praktikisht e pamundur, kjo për shkak se pika 9, e nenit 42, të Ligjit për Statusin, përcakton se: “Në rast të hapjes së pozicioneve të lira në gjykatën e apelit administrativ, procedura e lëvizjeve paralele do të jetë e hapur vetëm për gjyqtarë që kanë punuar për të paktën për pesë vjet në 9 vitet e fundit si gjyqtar në çështjet administrative”. Referuar këtij përcaktimi ligjor, pasur në konsideratë momentin e fillimit të funksionimit të gjykatave administrative, më datë 04.11.2013, aktualisht, në gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm nuk ka asnjë gjyqtar që të plotësojë kërkesat e ligjës, pra që në nëntë vitet e fundit, të ketë punuar për të paktën për pesë vjet si gjyqtar në çështjet administrative.

Nga ana tjetër, sa i përket pozicioneve të lira të përhershme në Gjykatën Administrative të Apelit, ato mund të plotësohen vetëm përmes ngritjes në detyrë të gjyqtarëve sa kohë, për të njëjtën arsye si më lart, ato nuk mund të plotësohen nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele.

Aktualisht, Këshilli është në proces plotësimi të dy pozicioneve të lira në Gjykatën Administrative të Apelit nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, të hapura me Vendimet nr.187 datë 28.05.2020 dhe nr.290 datë 06.07.2021, procedura këto që nuk kanë përfunduar ende.

Ndërkohë, më datë 23.11.2021, në Gjykatën Administrative të Apelit është krijuar një pozicion tjetër i lirë, për shkak të shkarkimit nga detyra të një gjyqtari me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar.

Ndaj, për pozicion të lirë të krijuar rishtazi në Gjykatën Administrative të Apelit është vendi për plotësimin e tij nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarëve.

Për këtë mbahet në konsideratë se Këshilli i Lartë Gjyqësor ka plotësuar tashmë kuadrin nënligjor të autorizuar nga ligji, për realizimin e këtij procesi.

Vlen të theksohet se sipas nenit 147, pika 1, i Kushtetutës: “Këshilli i Lartë Gjyqësor siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ndërkohë që sipas neni 147/a, pika 1, germa “a”, të saj: “1. Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme: a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve;...”.

Përgjegjësia e Këshillit të Lartë Gjyqësor është shtjelluar më tek edhe në ligjin “Për organet e qeverisjes së drejtësisë”, i ndryshuar, po ashtu edhe në Ligjin për Statusin.

Mbi këtë bazë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur dhe i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor projektvendimin “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Apelit, për një pozicion të lirë”, duke vlerësuar se vetë situata në këtë gjykatë dikton emergjencë në plotësimin e pozicionit të lirë të krijuar rishtazi, marrë shkas nga numri i reduktuar i gjyqtarëve dhe stoku i çështjeve të pashqyrtuara pranë saj.

Sa i përket përmbajtjes së projektvendimit, ai është i strukturuar në 4 Krerë, me të njëjtën përmbajtje si dhe në rastin e hapjes më parë të procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, me përjashtim të afatit të kandidimit, i cili mbetet të përcaktohet nga Këshilli në momentin e shqyrtimit të projektvendimeve, duke konsideruar se afati ligjor minimal i kandidimit është “të paktën dy javë nga data e shpalljes së procedurës”.

Bashkëlidhur projektvendimit janë edhe dy formularët tip, që kandidatët duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë në momentin e aplikimit, konkretisht: i) formulari – Vetëdeklarim për masë disiplinore dhe ii) formulari – Vetëdeklarim për situatën e papajtueshmërisë ambientale. Faleminderit!

*Naureda Llagami*: Faleminderit!

Lidhur me afatin?

**Ilir Toska:** Minimumi që duhet të përcaktojmë është dy javë. Nëse mendoni se duhet të jetë më e gjatë se dy javë.

Dy javë mbarojnë më 21. Mund ta lëmë deri në datën 24.

**Naureda Llagami:** Po, në përfundim të javës.

Jemi dakord me propozimin e projekt-aktit dhe të afatit të kandidimit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatës Administrative të Apelit për një pozicion të lirë. Afati i kandidimit është deri më datë 24.12.2021.

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 07.12.2021)*

**Pika 6 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për rihapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 14:26.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ilir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jastë.*
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 4. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 5. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për rihapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për rihapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”. Edhe ky projekt-akt është përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më shumë detaje fjalën ia jap z. Toska.

*Ilir Toska:* Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur edhe projektvendimin “Për rihapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”. Krahas projektvendimit, ju është përcjellë edhe relacioni shpjegues. Shkurtimisht mund t’ju parashtroj.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, referuar nenit 86 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së drejtësisë”, i ndryshuar dhe në zbatim të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është organi përgjegjës për emërimin, caktimin në pozicion, transferimin, ngritjen në detyrë, komandimin dhe riemërimin, vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, vendosjen e masave disiplinore dhe pezullimin, si dhe çdo detyrë tjetër e caktuar me ligj.

Legjislacioni në fuqi, konkretisht Ligji nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka parashikuar edhe mundësinë e komandimit të magjistratit, me pëlqimin e tij, në institucione të tjera brenda sistemit të drejtësisë, përfshirë këtu edhe në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Gjithashtu në dispozitat e këtij ligji, konkretisht në nenet 54, 55, 57 dhe 58, përcaktohet edhe procedura që duhet të ndjekë Këshilli, ashtu dhe institucionet e tjera në të cilat magjistrati mund të komandohet.

Në lidhje me rastin në shqyrtim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, fillimisht, me shkresën nr. {...} prot., datë 29.01.2020, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i kërkoi Këshillit komandimin e 6 (gjashtë) magjistratëve gjyqtarë në pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Mbi këtë kërkesë, Këshilli miratoi Vendimin nr.98 datë 26.02.2020 “Për hapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”. Në përfundim të afatit të shprehjes interes për komandim, pikërisht më datë 29 prill 2020, u konstatua se asnjë gjyqtar nuk kishte shprehur interes. Ky fakt u bë publik, përveç se iu njoftua zyrtarisht dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Më pas, me shkresën nr. {...} prot., datë 29.06.2020, Inspektori i Lartë të Drejtësisë iu drejtua përsëri Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke kërkuar rishpalljen e procedurës për komandimin tashmë të 7 (shtatë) magjistratëve gjyqtarëve në pozicionin e inspektorit pranë këtij Institucioni.

Edhe në këtë rast, Këshilli miratoi Vendimin nr.249 datë 09.07.2020 “Për hapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”. Në përfundim të afatit të shprehjes interes për komandim, pikërisht më datë 22 korrik 2020, u konstatua përsëri se asnjë gjyqtar nuk kishte shprehur interes. Ky fakt u bë publik, përveç se iu njoftua zyrtarisht dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në vijim, me shkresën nr. {...} prot., datë 24.08.2020, Inspektori i Lartë të Drejtësisë iu drejtua përsëri Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke kërkuar rishpalljen e procedurës për komandimin e 6 (gjashtë) magjistratëve gjyqtarëve në pozicionin e inspektorit pranë këtij Institucioni.



Edhe në këtë rast, Këshilli miratoi Vendimin nr.322 datë 17.09.2020 “Për hapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”. Në përfundim të afatit të shprehjes interes për komandim, pikërisht më datë 2 tetor 2020, u konstatua përsëri se asnjë gjyqtar nuk kishte shprehur interes. Ky fakt u bë publik, përveç se iu njoftua zyrtarisht dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Së fundi pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është depozituar shkresa nr. {...} prot., datë 29.09.2021, e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përmes të cilës Këshillit i kërkohet rishpallja e procedurës për komandimin e gjashtë (6) magjistratëve gjyqtarë në pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Lidhur me kërkesën e paraqitur mund të evidentohet se institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është një nga organet kushtetuese qeverisëse të sistemit të drejtësisë, veprimtaria e të cilit ka një rëndësi të veçantë në mirëfunksionimin e sistemit, por edhe të organeve të tjera qeverisëse të tij, ndërsa është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë. Në këtë kontekst, veprimtaria e magjistratit gjyqtar në funksionin e inspektorit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka një rëndësi të veçantë për mirëfunksionimin e këtij institucioni kushtetues.

Më tej, vlen të evidentohet se organika e miratuar e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë parashikon pasjen e 28 (njëzet e tetë) punonjësve të kategorisë inspektor, ku referuar nenit 209 (1) të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, gjysma e tyre duhet të jenë magjistratë, të komanduar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ose Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Po ashtu vlen të evidentohet se deri më sot, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka komanduar përkohësisht vetëm një magjistrat gjyqtar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, komandim i cili mbaron me përfundim të procedurave të ngritjes në detyrë për pozicionet e lira ku magjistrati i komanduar ka kandiduar. Këto procedura janë në proces, ndërsa ndodhen në fazën e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve për pozicionet e lira respektive, përfshirë dhe të kandidatit të komanduar në Zyrën e Inspektorit të Lartë

të Drejtësisë. Përveç kësaj, vlen të mbahet në konsideratë se magjistrati i vetëm i komanduar nga Këshilli në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, aktualisht nuk ushtron përkohësisht detyrën për arsye objektive shëndetësore (leje shtatzënie).

Nga ana tjetër, po në funksion të trajtimit të kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, vlen të evidentohet se situata aktuale në sistemin gjyqësor paraqitet tejte e vështirë, ndërsa ai ka mungesa të theksuara të gjyqtarëve në detyrë. Kështu, më datë 24.11.2021 (që është momenti që ju është përcjellë edhe propozimi), në sistemin gjyqësor mungojnë 181 gjyqtarë ose 44,36% e tyre, ku 74 janë vakanca të përhershme dhe 107 vakanca të përkohshme. Sot mungesat janë në nivelin e 184 gjyqtarëve. Mungesat më të mëdha janë në gjykatat e apelit. Ka mungesë të theksuar edhe në gjykatat e shkallës së parë. Të dhënat konkrete sa i përket situatës së sistemit gjyqësor ju janë përcjellë në formë tabelare ndaj nuk po zgjatem në analizën e tyre.

Në këtë kuadër, vlen të mbahet në konsideratë se mungesat më të mëdha në sistemin gjyqësor janë krijuar si pasojë e procesit të rivlerësimit kalimtar, ndërkohë që ky proces vijon dhe referuar trendit të derisotëm të mënyrës së përfundimit të këtij procesi, mund të mendohet se mungesat në sistemin gjyqësor do të vijnë të shtohen. Nga ana tjetër, prurje në sistemin gjyqësor është e pritshme të ndodhin vetëm pas qershorit 2022, ndërsa pritet të diplomohen 24 kandidatë për magistratë në Shkollën e Magistraturës.

Në kushtet si më lart, në funksion të kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sikurse kërkon pika 2, e nenit 54, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli do të duhet të bëjë “vlerësimin e nevojave të tij”, duke nënkuptuar në këtë rast nevojat e sistemit gjyqësor, sikundër po ashtu do të duhet të konsiderojë edhe përmbushjen e detyrimit ligjor për plotësimin me inspektor, përmes komandimit të magistratëve gjyqtarë, të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në rrethanat e evidentuara, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se Këshilli duhet të gjejë një zgjidhje të ekuilibruar, të tillë që të ndihmojë në mirëfunksionimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, por të mos dëmtojë në mënyrë të paarsyeshme nga ana tjetër mirëfunksionimin e sistemit gjyqësor. Një zgjidhje e tillë mund të jetë ajo rihapjes së procedurës së komandimit të gjyqtarit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura, por për një numër më të vogël pozicionesh të lira si inspektor nga sa kërkohet prej Inspektorit të

Lartë të Drejtësisë. Ky numër mund të jetë 2 ose 3 pozicione të lira, por gjithsesi kjo është një çështje që mbetet në vlerësim të Këshillit.

Ndaj sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës referuar bazës ligjore që përmendet në projektvendim, ka përgatitur projektvendimin që ju është përcjellë si propozim.

Sa i përket përmbajtjes së projektvendimit, ai është i strukturuar në tre krerë, ku Krerët I dhe III kanë të njëjtën përmbajtje, si dhe në rastet e hapjes dhe rihapjes së procedurës së komandimit të gjyqtarit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në këtë rast, në momentin e shqyrtimit të projektvendimit, Këshilli duhet të përcaktojë afatin e kandidimit në pikën 3, të tij, duke konsideruar se afati ligjor minimal i kandidimit është “të paktën dy javë nga data e shpalljes”. Po ashtu, Këshilli mbetet të përcaktojë edhe numrin e pozicioneve të lira për inspektor, në pikën 2 të projektvendimit.

Ndërkohë, në raport me projektvendimet e mëparshme, është shtuar një kre, Kreu II, titulluar “Dokumentacioni i kandidimit”, në të cilin, në pikën 4, përcaktohen dokumentet që duhet të paraqesë kandidati në momentin e aplikimit, konkretisht: a) Kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për komandimin në pozicionin e inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; b) Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail); c) Fotokopje të kartës së identitetit; ç) Vetëdeklarim për mospasjen masë disiplinore në fuqi, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi; d) Vetëdeklarim për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të shkronjës “dh”, pika 5, të nenit 209, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi; dh) Vërtetim/Dëshmi nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore) për mosqenien i dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale. Ndërsa në pikën 5 të këtij Kreu, përcaktohet se dokumentacioni sipas pikës 4, të këtij vendimi, dorëzohet pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Bashkëlidhur projektvendimit janë edhe dy formularët tip (sipas pikës 4 të projektvendimit), që kandidatët duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë në momentin e aplikimit, konkretisht: i) formulari - Vetëdeklarim për masë disiplinore dhe ii) formulari - Vetëdeklarim për situatën e papajtueshmërisë ambientale. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit zoti Toska!

**Ilir Toska:** Propozimi sa i përket afatit mund të jetë i njëjtë.

I vetmi diskutim është se ne kemi konsideruar që nuk duhet të pranohet tërësisht kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (që kërkon rishpalljen e 6 pozicioneve të lira). Kemi thënë që mund të jenë 2 ose 3 pozicione të lira, referuar situatës aktuale jo të mirë të sistemit gjyqësor sa i përket burimeve njerëzore.

Mbase ndonjë nga kolegët ka ndonjë mendim apo propozim të ndryshëm.

**Naureda Llagami:** Çfarë mendimi keni?

Jemi dakord me mendimin e Komisionit që të ketë dy pozicione?

**Ilir Toska:** Të përcaktojmë dy pozicione të lira dhe aftin 24 dhjetor.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në votim propozimin e Komisionit.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Rihapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesave për dy kandidatura për pozicionet e lira si inspektor. Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është deri më datë 24.12.2021.

\* \* \*

(Pika 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 07.12.2021)*

***Pika 7 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.389 datë 07.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 14:26.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi*** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 7. Ilir Toska*** (anëtar)
- 8. Alban Toro*** (anëtar)
- 9. Marçela Shehu*** (anëtare)

*10. Brikena Ukperaj (anëtare)*

*11. Erjon Muharremaj (anëtar)*

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 4. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 5. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjyrokastër, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.389 datë 07.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në aktin e radhës i cili ka të bëjë me përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjyrokastër, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.389 datë 07.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Edhe për këtë relator është z. Toska.

*Ilir Toska:* Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ju ka përcjellë projektvendimin e përmendur sa më lart nga Kryetarja, krahas edhe relacionit shpjegues. Shkurtimisht mund t’ju parashtroj se:

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në ushtrim të përgjegjësive të tij, ka miratuar edhe Vendimin nr.389 datë 07.10.2020, për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në këtë gjykatë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Brenda afatit të kandidimit në këtë procedurë ngritjeje në detyrë në Gjykatën e

Apelit Gjirokastër, afat ky që përfundoi më datë 23.10.2020, kandidoi vetëm z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Me Vendimin nr.541, datë 05.11.2020, Këshilli vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë, ndër të tjera, edhe në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të sipërpërmendur ku ka kandiduar vetëm z. {...}.

Procedura e verifikimit të kandidatit {...}, në kuadër të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastër për pozicionin e lirë si më lart, përfundoi me Vendimin e Këshillit nr.267 datë 28.06.2021, nëpërmjet të cilit u vendos kualifikimi i kandidatit dhe vijimi i procedurave të ngritjes në detyrë, ndër të tjera edhe në Gjykatën e Apelit Gjirokastër.

Me kualifikimin z. {...} në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastër për pozicionin e lirë si më lart, bazuar në Vendimin e tij nr.70 datë 07.02.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, Këshilli, me Vendimin nr.387, datë 22.09.2021, filloi procedurën e përzgjedhjes në kuadër të kësaj procedure ngritjeje në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastër.

Gjatë procedurës së përzgjedhjes, më datë 12.10.2021, kandidati z. {...} depozitoi në Këshill një kërkesë përmes të cilës tërhiqej nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, për pozicionin e lirë ku kishte kandiduar.

Mbi këtë kërkesë të kandidatit, me Vendimin nr.496 datë 25.10.2021, Këshilli vendosi: “Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr.389 datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion”.

Në situatën aktuale, rezulton se në procedurën për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr.389, datë 07.10.2020, të mos ketë më asnjë kandidat. Pikërisht për këtë shkak, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr.389 datë 07.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Shkaku i përgatitjes së këtij projektvendimi



është fakti se vazhdimi i mëtejshëm i kësaj procedure ngritjeje në detyrë është bërë i pamundur, pikërisht për mungesë të kandidatëve.

Referencat lidhore janë sipas pikës 3, të nenit 90, të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në nenit 95 të këtij Kodi.

Projektvendimi i propozuar përbëhet nga 1 pikë, në të cilën përcaktohet përfundimi i procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr.389 datë 07.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në projektvendim përcaktohet gjithashtu dhe momenti i hyrjes në fuqi, pikërisht menjëherë me publikimin e vendimit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Miratimi i projektvendimit të propozuar, hap rrugën për rihapjen nga Këshilli të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit, zoti Toska!

Kalojmë në miratimin e projekt-aktit sipas propozimit të Komisionit.

***Maksim Qoku:*** Dakord.

***Brunilda Kadi:*** Dakord.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Illir Toska:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Erjon Muharremaj:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Medi Bici:*** Pro.

***Naureda Llagami:*** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr.389 datë 07.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 7 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 07.12.2021)*

***Pika 8 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për nënshkrimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë së Shqipërisë mbi zbatimin e projektit pilot “Përdorimi i postës elektronike për dërgimin e fletëthirrjeve nga Gjykata e Shkalles së Parë Tiranë tek avokatët”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 14:26.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi*** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 7. Ilir Toska*** (anëtar)
- 8. Alban Toro*** (anëtar)
- 9. Marçela Shehu*** (anëtare)

*10. Brikena Ukperaj (anëtare)*

*11. Erjon Muharremaj (anëtar)*

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

*1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

*2. Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

*3. Kelment Greca, Drejtor pranë Drejtorisë së Organizimit të Gjykatave dhe Standardeve.*

*4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*

*5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

*6. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për nënshkrimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë së Shqipërisë mbi zbatimin e projektit pilot “Përdorimi i postës elektronike për dërgimin e fletëthirrjeve nga Gjykata e Shkalles së Parë Tiranë tek avokatët”.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin tjetër.

Në fakt ky projekt-akt ka të bëjë me miratimin e përmbajtjes së një memorandumit mirëkuptimi, i cili është një memorandum që do të lidhet (nëse nga ana e Këshillit jepet aprovimi) midis Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë së Shqipërisë mbi zbatimin e projektit pilot “Përdorimi i postës elektronike për dërgimin e fletëthirrjeve nga Gjykata e Shkalles së Parë Tiranë tek avokatët”

Ky memorandum ka ardhur si sugjerim dhe mbështetje nga Këshilli i Evropës, konkretisht nga Projekti SEJ 3, i cili ka rekomanduar Këshillit dhe i ofron asistencën mbi bërjen të mundur të këtij memorandumit dhe kryerjes së këtij projekti.

Gjithsesi, për më shumë detaje, do doja që t’ia jepja fjalën drejtorit z.Kelment Greca, i cili do të shpjegojë më në detaje qëllimin dhe mënyrën se si do funksionojë zbatimi i këtij memorandumit.

***Kelment Greca:*** Faleminderit!

*Zoti Greca lexon relacionin shpjegues të përgatitur për projektvendimin e sipërcituar.*

Projekti pilot zhvillohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe synon të përdorë postën elektronike për njoftimin e avokatëve në proceset civile, si përdorues të përhershëm të gjykatës. Projekti është zhvilluar si përgjigje ndaj problemeve të hasura në funksionimin e gjykatës gjatë pandemisë COVID–19, artikulluar në mënyrë të përmbledhur në deklaratën e CEPEJ “Mësimet e nxjerra dhe sfidat me të cilat përballlet gjyqësori gjatë dhe pas pandemisë COVID–19”, të datës 10 qershor 2020.

Më specifikisht fusha e veprimit të projektit është:

“Një zgjidhje teknike që do të shërbejë në fazën e pilotimit për t'u dhënë mundësi përdoruesve të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor, Tiranë si pjesë e sistemit ekzistues të menaxhimit të çështjeve gjyqësore për të përdorur sistemin e tyre për dërgimin elektronik të njoftimeve gjyqësore sipas nevojës dhe për të komunikuar me përdoruesit e jashtëm të sistemit (target grup–avokatët). Ai ofron karakteristika për të gjithë aktorët e brendshëm dhe të jashtëm të sistemit përmes:

1. Zgjerimit të aftësisë ekzistuese të sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore të gjykatës për të përdorur një nënsistem elektronik të njoftimit të gjykatës.

2. Sigurimit të shkëmbimit të të dhënave nga sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore të Tiranës drejt nënsistemit të ri të njoftimit për shkëmbimin e informacionit rreth statusit të njoftimeve (dorëzim, marrje dhe konfirmim njoftimi).

3. Sigurimi i një faqeje të regjistrimit të aplikacioneve në internet (duke përfshirë versionin celular) për avokatët për të iniciuar regjistrimin e përdoruesit në sistemin e njoftimit.

4. Sigurimi i një aplikacioni web për përdoruesit e sistemit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të sistemit (roli specifik i përdoruesit/ose atributet e caktuara për rolin ekzistues të përdoruesit) për verifikimin dhe autorizimin e kërkesave që vijnë nga përdoruesit e jashtëm (avokatë që regjistrohen në aplikacionin web ose aplikacionin mobil) në bazë të rregullave të përcaktuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Sigurimi i një aplikacioni të bazuar në ueb për konfigurimin dhe menaxhimin e kanaleve të njoftimeve dhe komunikimit (njoftimi i nënsistemit, e–mail, SMS, etj.) për përdoruesit e sistemit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

6. Sigurimi i një Aplikacioni me bazë web për Dhomën e Avokatisë për të menaxhuar anëtarët e tyre dhe njëkohësisht për të shkëmbyer informacione me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë”.

Projekti synon të ofrojë shërbime softuer, të cilat lehtësojnë komunikimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me aktorët e jashtëm të përfshirë në Procesin e Menaxhimit të Çështjeve të Gjykatës.

Qëllimi është i dyfishtë. Në njërin anë përmirësimi i efikasitetit të shërbimeve të menaxhimit të çështjeve të gjykatës, si ofrimi i një shërbimi më të mirë të brendshëm dhe për publikun. Nga ana tjetër, ai gjithashtu synon mbështetjen e palëve të përfshira, veçanërisht të avokatëve, për të pasur akses më të mirë dhe më të shpejtë në ngjarjet dhe informacionet e “çështjeve gjyqësore”.

Gjithashtu synohet të përfitohet nga mundësitë e sotme të teknologjisë, për të lejuar një zbatim të teknologjisë së re, me efekte minimale në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve ekzistuese, pa kërkuar një përmirësim të thellë dhe të kushtueshëm të teknologjisë aktuale CMS. Teknologjia e kërkuar moderne e web shërbimit, mundëson një ndërfaqe me zbatimin të modelit aktual CMS të të dhënave dhe njëkohësisht siguron ndërfaqe për çdo softuer tjetër të jashtëm i cili kërkon shkëmbimin e të dhënave dhe sjelljeve me CMS.

Zhvillimet e ofruara në projektin pilot përpiqen të udhëheqin zgjidhjen në një implementim standard, duke marrë parasysh gjendjen aktuale të teknologjisë dhe mundësitë brenda gjykatës.

Projekti pilot do të ofrojë ndaj avokatit dhe nëpunësve gjyqësorë civilë në gjykatë shërbimet e mëposhtme:

- Shërbim me bazë web–in për përdoruesit e regjistruar të sistemit të njoftimit gjyqësor.
- Shërbim SMS për përdoruesit e regjistruar të sistemit të njoftimit gjyqësor.
- Shërbim me e-mail për përdoruesit e regjistruar të sistemit të njoftimit gjyqësor.
- Shërbimi “Mobile App” për përdoruesit e regjistruar të sistemit të njoftimit gjyqësor.
- Shërbime me bazë uebin në kuadër të Sistemit të Dhomës së Avokatisë.

Ai bazohet në parashikimet e Kodit të Procedurës Civile mbi njoftimet elektronike të cilat përsuan ndryshime me ligjin nr.38/2017 “Për disa shtesa dhe

ndryshime në ligjin nr.8116 datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Këto ndryshime reflektohen në nenin 129, paragrafi 1 dhe 2, i Kodit të Procedurës Civile ku parashikohet thirrja në gjykatë, si më poshtë:

“Thirrja në gjykatë bëhet nëpërmjet njoftimit të letërthirrjes, e cila duhet të përmbajë gjykatën që e ka nxjerrë, emrin, mbiemrin e personit të thirrur, kohën e vendin e seancës gjyqësore, mosmarrëveshjen për të cilën thirret, kohën e njoftimit të aktit, si dhe pasojat ligjore në rast se personi i thirrur nuk paraqitet në gjykatë.

Gjykata, kur e çmon të dobishme dhe kur pala ose personi i tretë ka dhënë pëlqimin paraprak, urdhëron që thirrja në gjykatë të bëhet nëpërmjet njoftimit me mjete të komunikimit elektronik, sipas rregullave të përcaktuara në këtë kre.”

Ndërsa neni 141, i cili parashikon rregullat e njoftimit elektronik të akteve, përcakton se:

“Njoftimi elektronik i akteve bëhet me mjete të komunikimeve elektronike, nëpërmjet dërgimit nga punonjësi i gjykatës të letërthirrjes ose akteve të tjera që duhet t’i njoftohen personit të caktuar si marrës, në të dhënat e tij të kontaktit.

Ky njoftim duhet të pasqyrohet në një procesverbal të posaçëm, në të cilin duhet të tregohen të dhënat e kontaktit dhe mjeti i komunikimeve elektronike të përdorura për njoftim, data dhe ora e saktë e komunikimit, personi me të cilin komunikon dhe qëllimi i njoftimit.

Procesverbali hartohet nga sekretari gjyqësor dhe nënshkruhet prej tij dhe punonjësit të gjykatës të ngarkuar për kryerjen e njoftimeve.

Ky procesverbal bëhet pjesë e dosjes gjyqësore.

Rregulla të detajuara për mënyrën e njoftimit elektronik përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.”

Për zbatim të paragrafit të 5 të nenit të sipërcituar, Ministri i Drejtësisë ka miratuar Urdhrin nr.360 datë 05.09.2013 “Për mënyrën e njoftimit elektronik të akteve gjyqësore”. Me shkresën nr. {...} prot., datë 02.08.2021 depozituar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, Ministria e Drejtësisë ka njoftuar se është duke ndërmarrë masat për ndryshimet në Urdhrin e vitit 2013 me qëllim konformitetin e tij me ndryshimet e fundit ligjore.

Me realizimin e këtij projekti pilot synohet të evidentohen praktikat më të mira të njoftimit elektronik. Këto praktika do të ndihmojnë në zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të menaxhimit të çështjeve nëpër gjykata, për gjenerimin automatik të fletëthirrjeve dhe njoftimeve elektronike në të gjithë sistemin gjyqësor.

Këshilli i Lartë Gjyqësor është institucioni i cili disponon të drejtat e pronësisë së sistemeve të menaxhimit të çështjeve (ARKIT dhe ICMIS), dhe si i tillë ka detyrimin e zhvillimit të një sistemi të menaxhimit të çështjeve i cili plotëson nevojat e parashikuara në nenin 92 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar. Në mënyrë të përsëritur, ekspertët e partnerët e Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian kanë vënë në dukje nevojën për zhvillimin e një sistemi të menaxhimit të çështjeve i cili të ofrojë procedura të automatizuara dhe bashkëveprim të përdoruesve të gjykatës dhe nëpunësve civilë gjyqësorë. Automatizimi i njoftimeve elektronike nëpërmjet sistemit të menaxhimit të çështjeve, synim i këtij projekti shënon hapin e parë drejt përpunimit dhe zhvillimit të këtyre praktikave.

Mbi memorandumun:

Sa më sipër, për zhvillimin e projektit pilot, ku të do të marrin pjesë avokatët si palë dhe si përdorues të përhershëm dhe të mësuar me gjykatën, kërkohet bashkëpunimi dhe pëlqimi paraprak i tyre, nëpërmjet institucionit përfaqësues, Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë nëpërmjet dokumentit të propozuar për miratim: “Memorandumi i mirëkuptimit mbi zbatimin e projektit pilot “Përdorimi i postës elektronike për dërgimin e fletëthirrjeve nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë tek avokatët”.

Memorandumi përshkruan detyrat dhe metodat e monitorimit të projektit pilot dhe nënshkruhet nga dy palë. Këshilli i Lartë Gjyqësor si institucioni pronar i sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve dhe si administrues i politikave për gjykatat dhe nga ana tjetër Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë si organi përfaqësues i avokatëve sipas ligjit nr.55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” neni 25, pika 4, shkronja ‘a’

“4. Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë ushtron këto kompetenca:

a) nxjerr akte dhe kryen veprime juridike në lidhje me ushtrimin e profesionit të avokatit, të detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjithë anëtarët;”

Këto dy palë KLGJ dhe Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë janë organet kompetente dhe përfaqësues të palëve të interesuara në këtë proces. KLGJ si pronar i



Sistemit të menaxhimit të çështjeve ka të drejtën dhe detyrimin e zhvillimit të sistemit për të plotësuar nevojat e përdoruesit të gjykatës, ndërsa Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë përfaqëson avokatët të cilët do të jenë ndërvepruesit e vetëm në projektin pilot.

Nga ana e specialistëve nuk është gjykuar përfshirja e Ministrisë së Drejtësisë pasi ky institucion nuk zotëron asnjë tagër në lidhje me sistemin e menaxhimit të çështjeve apo administrimin e gjykatës. Neni 141 i Kodit të Procedurës Civile parashikon në mënyrë të qartë rolin e Ministrisë së Drejtësisë si organi i cili miraton rregulla për zbatimin e thirrjeve elektronike, proces të cilin janë duke e zhvilluar, ndërsa është parashikuar vënia në dijeni e Ministrisë së Drejtësisë mbi gjetjet e projektit pilot nëpërmjet dhënies së mendimit dhe oponentëve për nismën ligjore.

Gjithashtu nëpërmjet detyrave, të marra përsipër nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë mundësohet mbledhja e të dhënave të sakta elektronike dhe pëlqimi paraprak i avokatëve si subjekte të këtij projekti. Dhënia e pëlqimit të avokatëve është një detyrim dhe kusht ligjor parashikuar në nenin 129 paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Civile si dhe pjesë e procesit të rregullt ligjor.

Lidhur me strukturën e projektvendimit, ai përbëhet nga 2 pika.

Pika 1 e projektvendimit parashikon miratimin e përmbajtjes së memorandumit sipas dokumentit bashkëngjitur.

Pika 2 e projektvendimit autorizon Kryetaren e Këshillit të Lartë Gjyqësor të nënshkruaj, si përfaqësuese e Këshillit me Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë, memorandumimin e nevojshëm për zhvillimin e projektit pilot.

Datat e projekt-aktit të dorëzuar do të rishikohen përsëri në momentin e firmosjes, pasi mund të ketë ndryshime të tjera të datës, pasi ky është një projekt pilot dhe mund të ketë edhe rishikime të mundësive si nga projekti i Këshillit të Evropës, por edhe nga Gjykata e Tiranës. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Greca!

Ftoj kolegët për diskutime lidhur me përmbajtjen dhe me qëllimin e memorandumit.

**Alban Toro:** Mundem?

**Naureda Llagami:** Po, zoti Toro!

**Alban Toro:** Së pari unë kam një propozim për Kryetaren që ka menduar që t'ia nënshtrojë gjyqimit të Këshillit këtë lloj produkti (marrëveshjen) duke i dhënë fuqi ligjore, sikundër nuk ka vepruar në raste të tjera analoge. Mendoj që e argumentoj në këtë prizëm është shumë produktive për Këshillin.

E dyta, kam një çështje për teknikën. Nuk e di nëse Keli mund të na sqarojë. Bëhet fjalë për e-mailet që duhet të japin avokatët, duhet të jetë “Outlook” apo të zakonshëm?

**Kelment Greca:** Nuk është përcaktuar.

Ata kanë si e-mail zyrtar të tyrin që përdorin.

**Alban Toro:** Do të jetë e-mail i çfarëdoshëm apo “Outlook”?

**Kelment Greca:** I çfarëdoshëm.

Ai thjesht duhet të deklarojë atë si e-mail që e përdor.

**Alban Toro:** Dakord! Sepse në gjykatë ka pasur shpeshherë probleme me marrjen e njoftimeve, dhe për të evituar rastet kur avokati mund të spekulojë që unë nuk mora njoftimin, sepse e-maili juaj ka shkuar në “Spam”, unë do të sugjeroja që kur ta aplikoni nga pikëpamja teknike, të mundësoni faktin që në momentin që ai hap njoftimin e gjykatës nëpërmjet e-mailit, menjëherë të vijë një notifikim që ky e-mail u hap, për të evituar pastaj çdo lloj problemi me arsyetimin që e-maili shkoi në “Spam”, e-mailin nuk e mora. Pak a shumë, më duket siç vepron KPK-ja për subjektet e rivlerësimit. Kam përshtypjen që një softuer i tillë ka gjetur zgjidhje për këtë pjesë të njoftimit. Kaq kisha. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, Alban!

Nga kolegët?

**Brikena Ukperaj:** Kam unë një pyetje për zotin Greca.

Me sa unë arrita ta kuptoj në aspektin teknik, do të gjenerohet nga vetë sistemi ICMIS dhe ARKIT njoftimi apo do duhet që sekretarja të bëjë njoftim në e-mail? Është sistemi ai që e mundëson?

**Kelment Greca:** Do mundohemi që ta nxjerrim nga sistemi dhe ta bëjmë automatike.

**Brikena Ukperaj:** Sepse nëse është me e-mail, nuk ka nevojë për memorandum. Sot, nëpër gjykata ndodhin komunikime me e-mail në adresat e e-maileve që avokatët mund të vendosin në padi (sepse bëhet fjalë vetëm për çështje civile apo jo).

Ideja është që vetë sistemi ta gjenerojë njoftimin e avokatit.

**Kelment Greca:** Kodi i Procedurës na detyron të marrim një vendim paraprak, prandaj dhe është bërë kjo gjë.

**Brikena Ukperaj:** Kodi i Procedurës urdhëron ministrin të nxjerrë udhëzime përkatëse për sa i përket njoftimit elektronik. Ideja është që ne po pilotojmë një mënyrë njoftimi më efektive, të cilën do t'ia vëmë në dijeni Ministrin të Drejtësisë.

Bëhet fjalë për njoftim automatikisht nga sistemi, apo do jetë njoftim që punohet në një adresë zyrtare e-maili të gjykatës, që i shkon avokatit?

**Kelment Greca:** Do synohet të bëhet nga sistemi. Do synohet.

**Brikena Ukperaj:** Dakord. Nëse do jetë nga sistemi, normalisht duhet që e-maili i avokatit të jetë e-mail zyrtar, që të mos ndodhë siç na ndodhë ne këtu në Këshill, që na vijnë e-maile nga adresa anonime, me të dhëna madje shumë prekëse për proceset që kemi ne sot në Këshill. Prandaj ndoshta do të ishte mirë që edhe, këta, avokatët të kenë të hapura adresa e-maili zyrtare, të cilat konfirmojnë vërtetësinë e asaj përmbajtjeje të e-mailit që ka avokati.

Kaq. Ky ishte një sugjerim i imi. Nuk e di nëse merret parasysh nga ana teknike.

Ndërsa për sa i përket përmbajtjes së memorandumit, e gjej me vend dhe një iniciativë shumë e mirë në ndihmë të menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, Brikena!

Qëllimi, ai është në fakt Brikena, të paktën nga ekspertiza, që të realizohet në mënyrë automatike. Ndryshe nuk do të kishim ndonjë risi nëse do bëhej nga stafi

administrativ sepse nuk është ky qëllimi. Qëllimi është që të jetë automatik dhe për këtë arsye, duke qenë se këto ndërhyrje të jenë në sistem, për këto arsye propozuam që kjo lloj marrëveshje të jetë pjesë e mbledhjes plenare, sepse ne kemi mbajtur një standard që për çdo ndërhyrje që bëhet në sistem, qoftë edhe për projektet që na kanë asistuar, kemi kaluar përmes një vendimmarrjeje nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kështu që, nëse nuk kemi diskutime të tjera, mendojmë që ta kalojmë memorandumimin?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e përmbajtjes së Memorandumit të Mirëkuptimit i cili do të lidhet ndërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë, mbi zbatimin e projektit pilot “Përdorimi i postës elektronike për dërgimin e fletëthirrjeve nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë tek avokatët”.

2. Autorizimin e Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor për të nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit në emër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 8 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

28



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 07.12.2021)*

**Pika 9 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për dhënie leje të papaguar gjyqtares {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, relatore Brikena Ukperaj.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 14:26.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
11. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 4. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**
- 5. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për dhënie leje të papaguar gjyqtares {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, relatore Brikena Ukperaj.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në çështjen e radhës të rendit të ditës e cila ka të bëjë me dhënien e lejes të papaguar gjyqtares {...}, çështje e cila është përgatitur nga Komisioni i Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe do të relatohet nga zonja Ukperaj.

**Brikena Ukperaj:** Faleminderit, zonja Kryetare!

Në datën 17.11.2021, në Këshillin e Lartë Gjyqësor është regjistruar kërkesa e gjyqtares znj. {...}, aktualisht e komanduar në pozicionin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin në Këshill, për dhënie leje të papaguar, për një periudhë 1 (një) vjeçare, për arsye familjare.

Në kërkesën me shkrim znj. {...} parashtron rrethanat familjare mbi të cilat bazohet kërkesa për leje të papaguar, duke evidentuar faktin se bashkëshorti i saj do të ndjekë studimet pranë Chicago Kent Collage of Law, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në periudhën kohore 03.01.2022 deri në datë 23.12.2022. Në kuadër të këtij angazhimi, znj. {...} parashtron se së bashku me dy fëmijët e mitur, kanë aplikuar për pajisjen me vizë si familjarë të aplikantit kryesor. Në datë 26.10.2021 ata janë pajisur me vizat përkatëse nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe në datë 24.12.2021 do të udhëtojnë familjarisht për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me qëllim ndjekjen e programit të studimeve nga bashkëshorti i saj.

Sa i përket arsyeve konkrete për të cilat kërkohet dhënia e lejes së papaguar, znj. {...}, ndër të tjera, parashtron se: “...Arsyet për të cilat kërkohet përfitimin nga leja e papaguar, lidhen jo vetëm me të drejtën për jetë familjare, por edhe me detyrimin familjar për rritjen dhe përkujdesjen ndaj fëmijëve të mitur, pasi mirërritja e tyre varet tërësisht dhe në mënyrë ekskluzive nga prezenca ime si nënë.” Po ashtu, një rrethanë tjetër e prezantuar nga znj. {...} është fakti se ajo është pranuar nga i njëjti universitet për të ndjekur studimet master, por për shkaqe personale dhe familjare që konsistojnë në nevojën për përkujdesjen ndaj të fëmijëve të mitur (5 dhe 8 vjeç) në muajt e parë të zhvendosjes, nuk mund të ndjekë studimet në muajin janar 2022, sikundër është pranuar, por do të aplikojë për ndjekjen e tyre në muajin gusht, në sezonin e vjeshtës.

Bashkëlidhur kërkesës me shkrim, znj. {...} ka paraqitur dokumentacionin mbështetës si më poshtë:

- (i) Letër e pranimit për vazhdimin e studimeve master nga Chicago Kent Collage of Law (e përkthyer në shqip).
- (ii) Fotokopje e vizës së emigracionit (1-vjeçare);
- (iii) Certifikatë familjare;
- (iv) Bileta udhëtimi.

Me qëllim trajtimin e kërkesës së znj. {...}, referuar parashikimeve të nenit 24, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.72 datë 20.02.2019, znj. {...} i është kërkuar informacion në lidhje me ngarkesën aktuale në punë, në cilësinë e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, pranë Njësisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Znj. {...} ka paraqitur një raport me shkrim lidhur me ngarkesën aktuale të saj në punë, duke evidentuar se:

- (i) ka përfunduar të gjitha raportet analitike lidhur me vlerësimin etik dhe profesional të përshpejtuar për vitin 2019;
- (ii) ka përfunduar procedurat e shortit dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme për formimin e dosjes së vlerësimit për të gjitha procedurat e vlerësimit me qëllim gradimi;
- (iii) në lidhje me procedurat e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017–2019, nga 8 (tetë) procedura vlerësimi në të cilat është caktuar me short në cilësinë e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, ka përfunduar raportin analitik për 2

(dy) gjyqtarë, është zhvilluar shorti dhe pritet të plotësohet dosja e vlerësimit për 4 (katër) gjyqtarë dhe nuk është zhvilluar ende shorti për shkak se pritet të dërgohen statistikat e korigjuara për 2 (dy) prej tyre.

Znj. {...} është nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin, pasi është komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor për një periudhë 2 (dy) vjeçare, nga data 20.10.2020 deri në datë 20.10.2022.

Lidhur me këtë kërkesë, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, pasi ka analizuar bazën ligjorë të zbatueshme, konkretisht nenin 24 të ligjit për Statusin si dhe dispozitat e nenit 72 të vitit 2019 për lejet e papaguara që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vlerësuar se është rasti i pranimit të kërkesës për arsyet si vijon:

Në rastin konkret, gjyqtarja {...} ka paraqitur kërkesën në datë 17.11.2021, duke përcaktuar në mënyrë të saktë kohën e fillimit të lejes së papaguar të kërkuar dhe arsyen për të cilën ajo e kërkon atë, që lidhen me arsyet familjare, konkretisht duke lidhur datën e fillimit të lejes me kohën e udhëtimit të familjes së saj drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës (e provuar një e tillë).

Kërkesa përmban përshkrimin e arsyes për të cilën kërkohet leja e papaguar e cila konsiston në nevojën për t'u përkujdesur për fëmijët e mitur në muajt e parë që ata do të ndryshojnë vendbanimin, për shkak të studimeve të bashkëshortit dhe të drejtën për jetë familjare, për të qëndruar së bashku me bashkëshortin dhe fëmijët gjatë kohëzgjatjes së periudhës së studimeve. Po ashtu kërkesa ka të përcaktuar afatin 1 (një) vjeçar për të cilin ajo kërkohet.

Kërkesa është e shoqëruar me dokumentet shkresore që dëshmojnë arsyen e largimit të përkohshëm të familjes së saj drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me qëllimin e saj, zhvendosjen e përkohshme me qëllim përkujdesjen ndaj familjes dhe posaçërisht fëmijëve të mitur. Shkaku i bërë prezent nga gjyqtarja, referuar situatës nga e cila diktohet zhvendosja e familjes përkohësisht në një shtet tjetër, përbën në rastin konkret një shkak të përligjur për kërkesën për leje të papaguar të znj. {...}. Kjo pasi leja kërkohet pikërisht për t'u përkushtuar përkujdesjes dhe mirëqenies së fëmijëve të mitur, me qëllim për të lehtësuar përshtatjen e tyre me jetesën në një vendbanim dhe mjedis social të ri, si dhe për t'i ofruar mbështetjen bashkëshortit gjatë periudhës që ia do të ndjekë studimet pasuniversitare.



Rrethanat familjare të bëra prezent nga gjyqtarja, posaçërisht nevoja e domosdoshme për kujdesin dhe prezencën e nënës gjatë kohës që fëmijët e mitur do të ndryshojnë vendbanimin duke u vendosur në një mjedis të ri dhe të panjohur social, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me interesin më të lartë të fëmijëve të mitur duke marrë rëndësi thelbësore dhe lidhet pazgjidhshmërisht me nevojën për leje të papaguar sipas interesit më të lartë të fëmijës parashikuar në nenin 2 të Kodit të Familjes.

Sa i përket parimit të ruajtjes së funksionalitetit, në rastin konkret, znj. {...} nuk ushtron funksionin e gjyqtares pasi është e komanduar në pozicionin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në lidhje me funksionalitetin e njësisë në të cilën ajo është e komanduar, referuar ngarkesës aktuale dhe ecurisë së procedurave të vlerësimit të përshkruara në raportin e paraqitur prej saj, vlerësohet se dhënia e lejes së kërkuar nga gjyqtarja për një periudhë 1–vjeçare, nuk cenon funksionalitetin e njësisë përkatëse të Këshillit. Për pasojë, dhënia e lejes për arsye familjare për një periudhë 1–vjeçare për gjyqtaren, duke vlerësuar të drejtën për jetë familjare si dhe në veçanti parimin e “interetit më të lartë të fëmijës”, në proporcion me funksionalitetin e njësisë në të cilën gjyqtarja është aktualisht e komanduar, vlerësohet nga Komisioni se nuk do të dëmtonte përmbushjen me efikasitet dhe në kohë të detyrave të nëpunësit përgjegjës për vlerësimin.

Për sa më sipër rezulton se kërkesa e gjyqtares {...} për leje të papaguar për arsye familjare, për një periudhë 1–vjeçare, përmbush kriteret e përcaktuara në neni 24, të ligjit nr.96/2016 dhe atyre të përcaktuara në vendimin nr.72 datë 20.05.2019 të Këshilli i Lartë Gjyqësor. Lidhur me kohën e fillimit të lejes Komisioni vlerëson se data 24.12.2021, e propozuar nga gjyqtarja, i krijon asaj mundësinë e mbylljes së raporteve analitike që janë në përfundim e dorëzimin e punës.

Sa i përket procedurave të vlerësimit në të cilat znj. {...} është përzgjedhur me short në cilësinë e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, në referim të kreut VII, pika 8, shkronja ç) të vendimit nr.72 datë 20.05.2019, Komisioni vlerëson se zëvendësimi i saj si nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin do të bëhet në ditën e fillimit të lejes së papaguar, ngarkesë pune e cila do të rishpërndahet me short tek nëpunësit e tjerë të vlerësimit që ushtrojnë detyrën pranë kësaj Njësie.

Për sa më sipër, Komisioni ka përgatitur edhe projekt–aktin përkatës, duke i propozuar mbledhjes plenare: Miratimin e kërkesës së znj. {...}, gjyqtare pranë

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, aktualisht e komanduar në pozicionin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, në Njësinë e Vlerësimit Etik dhe Profesional pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për dhënie leje të papaguar, për arsye familjare, për një periudhë 1–vjeçare, nga data 24.12.2021 deri në datë 24.12.2022.

Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares {...} dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje.

Për zbatimin e këtij vendimi, referuar efekteve financiare duhet të njoftohet Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Është parashikuar edhe e drejta e ankimit.

Lidhur me hyrjen në fuqi, duke qenë para një akti individual, ai hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit sipas nenit 98 pika 2 të Ligjit nr.115/2016.

Lidhur me të drejtën e ankimit, referuar parashikimeve të nenit 100, të ligjit nr.115/2016 ndryshuar me ligjin nr.47/2016, ankimim i cili ushtrohet pranë Gjykatës Administrative të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit, zonja Ukperaj!

Ftoj kolegët nëse kanë diskutime.

Nëse jo, kalojmë në procesin e votimit.

***Maksim Qoku:*** Dakord.

***Brunilda Kadi:*** Dakord.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ilir Toska:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Erjon Muharremaj:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Medi Bici:*** Dakord.

***Naureda Llagami:*** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e kërkesës së znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, aktualisht e komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për dhënie leje të papaguar për arsye familjare, për një periudhë 1–vjeçare, nga data 24.12.2021 deri në datë 24.12.2022.

2. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares znj. {...} dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

\* \* \*

(Pika 9 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 07.12.2021)*

**Pika 10 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.120 datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 14:26.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Illir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.*
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 4. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 5. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

**RENDI I DITËS:**

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.120 datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin tjetër të radhës i cili ka të bëjë me renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.120 datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për më shumë detaje fjalën ia jap zotit Toska.

*Ilir Toska:* Faleminderit!

Këshillit i është përcjellë për miratim projektvendimi për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.120 datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ju është përcjellë edhe relacioni shpjegues për këtë projektvendim. Shkurtimisht mund t’ju parashtroj se:

Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuara nga ligji, në kuadër të plotësimit të pozicionet e lira në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka hapur

disa procedura ngritjeje në detyrë, ndër të tjera, edhe për një pozicion të lirë, me Vendimin nr.120 datë 01.04.2021.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë për pozicionin e lirë të sipërpërmendur, që ka përfunduar më datë 14.04.2021, aplikoi një kandidat, konkretisht znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, aktualisht gjyqtare e skemës së delegimit e caktuar për një periudhë kohe në Gjykatën e Apelit Durrës.

Sipas pikës 9, të nenit 48, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në një procedurë ngritjeje në detyrë për një pozicion të lirë, Këshilli i Lartë Gjyqësor bën renditjen e kandidatëve që përmbushin kriteret, renditje kjo që bëhet në funksion të përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, i cili do të duhet të ngrihet në detyrë në atë pozicion të lirë.

Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Këshilli realizoi procedurën e verifikimit të plotësimit nga ata në rastin konkret për të vetmin kandidat të kriterëve të më poshtme:

1) “përvojës profesionale minimale”, sipas shkronjës “b”, pika 2, të nenit 47, të Ligjit për Statusin;

2) “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, sipas pikës 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin;

3) “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, sipas nenit 8, të Ligjit për Statusin;

4) “dhënies së pëlqimit (ai/ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, sipas pikës 4, të nenit 135, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 3, të nenit 47, të Ligjit për Statusin;

5) “të pasurisë dhe figurës”, sipas pikave 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin.

Për kandidaten e vetme, znj. {...}, Këshilli verifikoi plotësimin nga ajo të kriterëve të kandidimit dhe me Vendimin nr.354 datë 09.09.2021, vendosi kualifikimin e

saj dhe vijimin e procedurës për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë ku ka kandiduar.

Ndërkohë, krahas procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit, paralelisht, për kandidaten kanë vijuar edhe procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, konkretisht: 1) vlerësimi me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013–2016 (periudhën e rivlerësimit kalimtar), referuar pikës 5, të nenit 171, të Ligjit për Statusin; 2) vlerësimi i përsheptuar për vitin 2019, referuar pikës 3, të nenit 25, “Dispozitë kalimtare”, shtuar në këtë ligj me Ligjin nr.48/2019. Kryerja e vlerësimit etik dhe profesional për kandidaten në këtë rast, përveç se një detyrim ligjor, ndërsa ajo nuk kishte asnjë vlerësim të tillë, është vlerësuar e domosdoshme për sa kohë ajo kandidonte për ngritjen në detyrë në një gjykatë të specializuar, ku një vlerësim në nivelin e përgjithshëm “i pamjaftueshëm”, pra një vlerësim etik dhe profesional me cilësi të dobët, jo vetëm nuk do të përlligjte ngritjen në detyrë, por, përkundrazi, referuar pikës 6, të nenit 95, të Ligjit për Statusin, do të përbënte shkas për dërgimin e raportit të vlerësimit Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të vlerësuar fillimin e hetimit dhe, më tej, të procedimit disiplinor ndaj kandidates, duke vënë kështu në diskutim nga ana tjetër, plotësimin e kriterëve të kandidimit prej saj. Një rrethanë e tillë në rastin konkret lidhet veçanërisht me vlerësimin e përsheptuar të kandidates për vitin 2019, ndërsa sa i përkonte vlerësimit me qëllim gradimin për periudhën e rivlerësimit kalimtar, një moment i tillë është i tejkaluar sa kohë kandidatja ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, çka, referuar përcaktimit të shkronjës “c”, pika 1, të nenit 59, të Ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, presupozon se kandidatja ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, pra se ajo është vlerësuar “E aftë”, pra që ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve ose viktimave, si dhe se ka qenë efiçent dhe efektiv në masë të pranueshme përgjatë periudhës së rivlerësimit kalimtar, sikurse një gjë e tillë përcaktohet në shkronjën “a”, të nenit 44, të këtij ligji.

Me kualifikimin e kandidates znj. {...}, bazuar në pikën 24, të Vendimit të Këshillit nr.70 datë 07.02.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve” Këshilli, me Vendimin nr.394 datë 22.09.2021, filloi procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e tij nr.120

datë 01.04.2021. Me këtë vendim, si relator i procedurës së përzgjedhjes jam caktuar unë si anëtar i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Më datë 22.09.2021, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 30, të Vendimit të Këshillit 70/2020, kandidatja e kualifikuar u njoftua për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për pozicionin e lirë ku ajo kandidonte, si dhe për caktimin e relatorit. Kandidatja nuk paraqiti kundërshtime ose kërkesë për përjashtimin e relatorit apo për ndonjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit.

Në zbatim të shkronjës “a”, pika 47, të Vendimit nr.70/2020, relatori administroi dokumentacionin përkatës të kandidates, që gjendej në dosjen e saj personale apo në praktikën dokumentare të procedurës së verifikimit të plotësimit të kriterëve të kandidimit. Po ashtu, relatori administroi edhe vendimet përkatëse të Këshillit në lidhje me dy vlerësimet etike dhe profesionale për të.

Konkretisht, lidhur me vlerësimet etike dhe profesionale, për kandidaten e vetme znj. {...} u konstatua se:

a) Sipas Vendimit të Këshillit nr.273, datë 01.07.2021, kandidatja është vlerësuar/graduar për periudhën e vlerësimit 2013–2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 391 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional” të miratuar me këtë vendim; b) Sipas Vendimit të Këshillit nr.274, datë 01.07.2021, kandidatja është vlerësuar për vitin 2019, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 391 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional” të miratuar me këtë vendim.

Dy vlerësimet etike dhe profesionale të kandidates znj. {...} të miratuara me Vendimet e Këshillit nr.273 dhe nr.274 datë 01.07.2021, u konstatua të jenë bërë përfundimtarë, ndërsa ndaj tyre nuk është paraqitur ankim. Lidhur me këtë, konstatohet se vendimet si më lart të Këshillit i janë dërguar për njoftim kandidates në adresën e gjykatës ku ajo ushtronte funksionin (Gjykatën e Apelit Durrës), me shkresën përcjellëse të datës 09.07.2021, ku janë dorëzuar më datë 12.07.2021. Ndërkohë, me shkresën nr. {...}, datë 15.11.2021, Gjykata Administrative e Apelit konfirmon se kandidatja nuk ka paraqitur ankim ndaj vendimeve si më lart të Këshillit për vlerësimin e saj etik dhe profesional.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, në kushtet kur në këtë procedurë ngritjeje në detyrë ka kandiduar vetëm një kandidat dhe, për rrjedhojë, edhe



në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve është vetëm një i tillë, u vlerësua se nuk ka vend për ndjekjen e hapave, kritereve dhe përparësive sipas përcaktimeve të Kreut IV, të Vendimit të Këshillit nr.70/2020, në funksion të renditjes së kandidatëve. Nga ana tjetër, në respektim të përcaktimeve të Seksionit B, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit nr.70/2020, relatori përgatiti projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.120 datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Projektvendimi është i strukturuar në 3 pika.

Sipas pikës 1 të projektvendimit, Këshillit i propozohet të miratojë renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.120 datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: 1) Znj. {...}.

Në pikën 2 të projektvendimit, përcaktohet se një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet se ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Projektvendimi “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.120 datë 01.04.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, u shqyrtua nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në mbledhjen e datës 26.11.2021, sikurse përcaktohet në Seksionin C, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit nr.70/2020, ku pasi ka konstatuar si të plotë dokumentacionin e administruar për kandidaten në këtë procedurë përzgjedhjeje, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Faleminderit, zoti Toska!

Nëse nga kolegët nuk ka ndonjë diskutim, kalojmë në votim projekt-aktin e përcjellë nga Komisioni.

*Maksim Qoku*: Dakord.

*Brunilda Kadi*: Dakord.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Illir Toska*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Erjon Muharremaj*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.120 datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 10 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 07.12.2021)*

**Pika 11 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, i gjyqtarit {...}, relator z. Erjon Muharremaj.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 14:26.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                             |                          |
|-----------------------------|--------------------------|
| <b>12. Naureda Llagami</b>  | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>13. Maksim Qoku</b>      | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>14. Medi Bici</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>15. Fatmira Luli</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>16. Brunilda Kadi</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>17. Ilir Toska</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>18. Alban Toro</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>19. Marçela Shehu</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>20. Brikena Ukperaj</b>  | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>21. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |

*Shënim 1:* Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Dritan Hallunaj*, i cili u largua pas trajtimit të çështjes nr. 10.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 4. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 5. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

11. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, i gjyqtarit {...}, relator z. Erjon Muharremaj.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, për gjyqtarin {...}. Relator është zoti Muharremaj.

*Dritan Hallunaj:* Përpara se të fillojë Erjoni, ju kërkohet ndjesë, por mua për arsye objektive më duhet të dal nga platforma dhe të mos marrë pjesë në këto tre pikat e fundit të rendit të ditës.

*Naureda Llagami:* Faleminderit, Dritan!

*(Largohet nga platforma zoti Hallunaj dhe nuk merr më pjesë në vazhdimin e mbledhjes.)*

*Naureda Llagami:* Kalojmë, fjala tek zoti Muharremaj!

***Erjon Muharremaj***: Faleminderit!

Siç jeni njohur prej kohësh, është përgatitur projektraporti i vlerësimit për gjyqtarin {...}, për periudhën e vlerësimit 2013–2016, kohë gjatë së cilës gjyqtari ka ushtruar detyrën e tij në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Pasi është njohur me projektraportin, gjyqtari ka paraqitur kundërshtimet e veta dhe për dy nga treguesit për të cilat ai ka paraqitur kundërshtime, unë do të ndalem më në hollësi për ta argumentuar qëndrimin tim në cilësinë e relatorit pas marrjes së kundërshtimeve prej gjyqtarit.

Sa i përket kriterit të “Aftësive profesionale të gjyqtarit”, në lidhje me treguesin e “Aftësisë për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave”, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, pikëzimi 25 pikë.

“Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështje”, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, pikëzimi 25 pikë.

Në projektraportin e vlerësimit lidhur me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” është propozuar që gjyqtari {...} të vlerësohet në nivelin “mbi mesataren”, duke e pikëzuar me 12 pikë, pasi nga analiza e vendimeve burim vlerësimi, kryesisht i vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari, evidentohet se vendimet janë relativisht shumë të gjata (variojnë 37–138 faqe), në arsyetimin e të cilave gjyqtari analizon koncepte të së drejtës dhe institutet, të cilat edhe pse në thelb ia rrisin vlerën një vendimi gjyqësor në kuptimin akademik të tij, mund të humbasin prakticitetin, koncizitetin dhe vëmendjen në zgjidhjen e analizës së çështjes konkrete. Gjithashtu, evidentohet se gjyqtari njih mirë praktikën gjyqësore vendase dhe të huaj, duke elaboruar dhe duke bërë pjesë të arsyetimit të vendimit edhe pjesë nga kjo jurisprudencë, por nga ana tjetër konstatohet që gjyqtari nuk kufizohet thjesht në konkluzionin e arritur nga kjo jurisprudencë, por duke cituar pasazhe të tëra të saj në përmbajtje të arsyetimit të vendimit, çka në ndonjë rast e bën tepër të detajuar vendimin, në vlerësimin tim, cenon qartësinë dhe koncizitetin e vendimit.

Lidhur me këtë tregues, gjyqtari ka paraqitur kundërshtime, duke parashtruar fillimisht vlerësimin lidhur me këtë tregues të mbajtur në vendimin nr.402 datë 25.04.2021 të KPK, si dhe në projektraportin e vlerësimit të njoftuar gjyqtarit. Pas pasqyrimin të këtyre vlerësimeve, gjyqtari parashtron se (citoj):

“Dëshiroj të theksoj se nga ana ime janë përzgjedhur për vlerësim tre vendime konkretisht: i) Vendimi Nr.409 datë 25.07.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër 37 faqe ii); Vendimi Nr.887 (4396) datë 04.11.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër 22 faqe; iii) Vendimi Nr.266 datë 09.09.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë 138 faqe. Nga këto vendime vetëm njëri prej tyre konsiderohet voluminoz. Megjithatë duhet theksuar se ky vendim është sinteza e një procesi të vështirë për të cilin ishte vendosur rigjykimi nga Gjykata e Apelit Shkodër. Ky proces është zhvilluar me procedurën e gjykimit të zakonshëm me disa të pandehur, si dhe përbënte një çështje sensitive në atë kohë e që meritonte një vëmendje të posaçme që nga ana e gjykatës të pasqyrohej me saktësi të gjitha faktet që kanë rezultuar gjatë gjykimit, si dhe të analizoheshin të gjitha pretendimet e palëve. Po ashtu, në këtë vendim janë trajtuar disa institute të së drejtës që ishin të domosdoshme për zgjidhjen e çështjes, të cilat janë cituar në mënyrë të detajuar dhe në projekt-raportin e vlerësimit. Dua të theksoj se ky është vendimi më profesional dhe më i arsyetuar i dhënë nga ana ime gjatë gjithë karrierës si gjyqtar, për shkak se trajtohen pothuajse të gjitha institutet e së drejtës penale dhe procedurale penale, pasi çështja ka qenë e tillë që duhej domosdoshmërisht të analizoheshin paraprakisht për zgjidhjen e drejtë të çështjes sepse në të kundër vendimi mund të kualifikohej si i paarsyetuar. Në këtë vendim është bërë interpretim pajtues me kushtetutën i nenit 278 të Kodit Penal.

Tashmë nga shumica e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor lidhur me koncizitetin e vendimeve, në raste të ngjashme, është mbajtur qëndrimi se magjistrati duhet të pikëzohet me vlerësimin maksimal. Ndodhur në këto kushte, në respektim të parimit të koherencës institucionale mendoj se duhet të mbahet i njëjti qëndrim edhe në rastin tim.” – këtu e përfundoj citimin.

Në cilësinë e relatorit, në kushtet kur Këshilli i Lartë Gjyqësor në mbledhjen plenare të datës 23.11.2021 pranoi propozimin për ndryshimin e pikëzimit të gjyqtarës me argumentin që në vlerësimin e treguesve të kriterit “Aftësitë profesionale të gjyqtarit” ka njëfarë subjektiviteti, si dhe në kushtet kur ky Këshill në mbledhjen plenare të datës 23.11.2021, ka mbajtur këtë qëndrim, në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...} për vitin 2019 e ka vlerësuar këtë tregues me shkallë aftësie “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë, në cilësinë e relatorit propozoj ndryshimin e vlerësimit dhe

pikëzimin e njëjtë të këtij treguesi edhe për periudhën 2013-2016, pra, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, pikëzimi 15 pikë.

Sa i përket treguesit “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit”, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, pikëzimi 10 pikë.

Në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik”, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, pikëzimi 25 pikë.

Për kriterin e parë të “Aftësive profesionale të gjyqtarit”, propozimi i ri është që të pikëzohet me 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Në lidhje me kriterin e “Aftësive organizative të gjyqtarit”, sa i përket treguesit të “Respektimit të afateve ligjore”, shkalla e aftësisë “0-10%”, pikëzimi 15 pikë.

“Plotësimi i standardeve minimale kohore”, shkalla e aftësisë “0-10%”, pikëzimi 5 pikë.

“Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve, pikëzimi 5 pikë.

Sa i përket treguesit të “Rendimentit të përfundimit të çështjeve gjyqësore”, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 74.28%, që përkon me një pikëzim 2 pikë. Në kushtet kur gjyqtari për periudhën gjithë periudhën e vlerësimit ka gjykuar në total 582 çështje (krime dhe kundërvajtje), pra, 94% më shumë se standardi sasior i punës, në projektraportin e vlerësimit është propozuar që gjyqtari për këtë tregues të vlerësohet dy nivele më të lartë se ai që i përket përqindjes së pikëzimit, nëse do të ishte bërë një vlerësim matematikor, pra të vlerësohet në nivelin “mbi 87-93%”, duke e pikëzuar me 6 pikë.

Lidhur me këtë tregues gjyqtari, ka paraqitur kundërshtime, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se (citoj):

“Nga tabelat e mësipërme rezulton se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër për vitet 2014, 2015 dhe 2016 (datë 18.11.2016 kur jam transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë) unë kam marrë me short 969 çështje dhe kam mbyllur me vendim 924 çështje. Kjo do të thotë se rendimenti në punë ka qenë mbi 94% (mbi standardin e përcaktuar). Ndërkohë, nëse do të marrim në analizë çështjet që janë shortuar edhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe Lezhë, ku unë kam qenë i deleguar dhe duke iu referuar periudhës deri më datë 08.10.2016 unë kam marrë me short 955 çështje dhe kam

mbyllur me vendim 889 çështje. Kjo do të thotë se rendimenti në punë ka qenë mbi 94% përtej standardin.”

Referuar akteve të depozituar nga gjyqtari në mbështetje të kundërshtimeve të paraqitura, rezulton se:

Për vitin 2014 gjyqtarit i janë caktuar në total 277 çështje (276 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe 1 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë) dhe ka përfunduar 182 çështje, rendimenti për vitin 2014 rezulton të jetë 65.7%;

Për vitin 2015 i janë caktuar në total 330 çështje (325 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe 5 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë) dhe ka përfunduar 357 çështje (354 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe 3 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë) rendimenti për vitin 2015 rezulton të jetë 108%;

Për vitin 2016 i janë caktuar në total 379 çështje (375 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, 1 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe 3 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë) dhe ka përfunduar 390 çështje. Rendimenti për vitin 2016 rezulton të jetë 91.82%.

Në total, për gjithë periudhën e vlerësimit gjyqtarit i janë caktuar 986 çështje dhe ka përfunduar 929 çështje, duke rezultuar kështu norma e likuidimit të çështjeve për gjithë periudhën e vlerësimit 94.21%.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, për të vlerësuar këtë tregues, vlerësuesi nuk bën vetëm një veprim matematikor për të përcaktuar rendimentin e përfundimit të çështjeve, por ai bazohet edhe në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i nivelit të përqindjes. Ky vlerësim mund të shkojë deri në pikëzimin maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda vitit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës në fuqi. Në rastin konkret, rezulton se gjyqtari {...} për periudhën e vlerësimit ka gjykuar brenda vitit kalendarik më shumë se 50%, madje ka gjykuar 94% më shumë se standardi sasior i punës. Në këto kushte, në cilësinë e relatorit vlerësoj se gjyqtari për këtë tregues duhet të pikëzohet në nivelin maksimal të tij, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Sa i përket treguesit “Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor” është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, pikëzimi 15 pikë.



“Numri mesatar i seancave gjyqësore dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive”, “1-3 seanca”, 15 pikë.

“Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, pikëzimi 20 pikë.

“Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes”, “shumë e lartë”, 5 pikë.

“Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes”, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, pikëzimi 10 pikë.

Për kriterin e “Aftësive organizative të gjyqtarit”, nga propozimi fillestar prej 96 pikësh, propozoj t’i shtohen 4 pikë dhe të pikëzohet me 100 pikë. Niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Sa i përket kriterit të “Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale” nuk ka asnjë tregues në lidhje me cenimin e këtij kriteri, prandaj propozohet pikëzimi maksimal prej 100 pikësh dhe niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Ndërsa në lidhje me kriterin e “Aftësive personale dhe angazhimit profesional”, në kushtet kur rezultojnë që sa i përket “Pjesëmarrjes së gjyqtarit në formimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale”, angazhimi i tij është për 34 ditë dhe për këtë propozohet vlerësimi me 20 pikë.

Sa i përket “Disponueshmërisë së gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë...” ka të dhëna, pasi është angazhuar si lehtësues në një aktivitet dhe për këtë propozohet pikëzimi me 5 pikë.

Sa i përket “Pjesëmarrjes së gjyqtarit në veprimtari ndërinstytucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, rezulton që ai është zgjedhur me vendimin nr.46 datë 14.12.2015 si anëtar i Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Gjyqësore Kombëtare. Po ashtu me vendimin nr.47 datë 14.12.2015 është zgjedhur si anëtar i Komitetit për Marrëdhëniet me Institucionet Shtetërore, gjithashtu është angazhuar edhe si pedagog i jashtëm në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës; prandaj në kushtet kur ka të dhëna për angazhimin e tij propozohet pikëzimi me 5 pikë.

Në kushtet kur edhe ka realizuar publikime ligjore akademike gjatë kësaj periudhe, propozohet gjithashtu pikëzimi me 5 pikë.

Për kriterin e “Aftësive personale dhe angazhimit profesional”, propozohet pikëzimi me 100 pikë, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Vlerësimi i përgjithshëm, në kushtet kur propozohet pikëzimi me 100 pikë për secilin prej katër kriterëve, në total, propozimi im si relator është që gjyqtari të pikëzohet me 400 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm". Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Keni ndonjë diskutim lidhur me përmbajtjen e raportit?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projektraportit sipas propozimit të bërë nga relatori, ku në total janë 393 pikë dhe niveli i përgjithshëm i vlerësimit është "Shkëlqyeshëm".

**Erjon Muharremaj:** Më falni zonja Kryetare!

Propozova që të ndryshohet vlerësimi nga 393, të bëhet 400 pikë dhe niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

**Naureda Llagami:** Po!

Atëherë, jemi dakord me propozimin e relatorit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë në tërësi raportin me ndryshimin e bërë?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord. Dua që të përgëzoj gjyqtarin i cili është i pari që u vlerësua maksimalisht dhe shpresoj dhe besoj që ai do të vazhdojë ta ketë këtë vlerësim edhe në të ardhmen. Faleminderit!

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013–2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

\* \* \*

(Pika 11 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 07.12.2021)*

**Pika 12 e rendit të ditës me objekt:** Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datave: 25.10.2021, 26.10.2021, 28.10.2021, 03.11.2021, 10.11.2021, 16.11.2021, 17.11.2021.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 14:26.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Ilir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

*Shënim 1:* Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Dritan Hallunaj*, i cili u largua pas trajtimit të çështjes nr. 10.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
5. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

12. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datave: 25.10.2021, 26.10.2021, 28.10.2021, 03.11.2021, 10.11.2021, 16.11.2021, 17.11.2021.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, konkretisht të datave 25 tetor, 26 tetor, 28 tetor, 3 nëntor, 10 nëntor, 16 nëntor, 17 nëntor. Jeni dakord?

*Maksim Qoku:* Dakord.

*Brunilda Kadi:* Dakord. Me përjashtim të atyre procesverbaleve ku nuk kam marrë pjesë në mbledhje.

*Ilir Toska:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Dakord.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Erjon Muharremaj:* Pro. Me përjashtim të procesverbalit të mbledhjes plenare të datës 17.11.2021, në të cilin mund të votoj vetëm për pikën e parë në të cilën kam marrë pjesë, pasi për arsye objektive jam larguar nga mbledhja dhe nuk kam pasur mundësi të diskutojë pikat e tjera. Faleminderit!

*Brikena Ukperaj:* Pro.

**Medi Bici:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 25.10.2021, 26.10.2021, 28.10.2021, 03.11.2021, 10.11.2021, 16.11.2021 dhe 17.11.2021.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 12 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 07.12.2021)*

**Pika 13 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska):

13.1 Për caktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z/znj \_\_\_\_, për gjykimin e një çështjeje gjyqësore në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

13.2 Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.<sup>1</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami<sup>2</sup>***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 14:26.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)*</b>       |
| <b>2. Maksim Qoku</b>     | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>   | <b>(anëtare)</b>         |

<sup>1</sup> Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

<sup>2</sup> Në pamundësi për t'u rilidhur me platformën, pas një shkëputjeje të energjisë elektrike, nuk mori pjesë në vijimin e trajtimit të kësaj çështjeje znj. Llagami, për pasojë drejtimin e mbledhjes e mori zoti Qoku, Zëvendëskryetar.

- |                             |                  |
|-----------------------------|------------------|
| <b>6. Ilir Toska</b>        | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>7. Alban Toro</b>        | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>8. Marçela Shehu</b>     | <b>(anëtare)</b> |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b>   | <b>(anëtare)</b> |
| <b>10. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>  |

**Shënim 1:** Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Dritan Hallunaj**, i cili u largua pas trajtimit të çështjes nr. 10.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënive me Jashtë.**
- 3. Valbona Bako, Përgjegjëse pranë Sektorit të përgatitjes së dokumentacionit dhe përfaqësimit në gjykatë.**
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**
- 6. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

13. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska):

13.1 Për caktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z/znj \_\_\_\_, për gjykimin e një çështjeje gjyqësore në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

13.2 Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Çështja e fundit e rendit të ditës ka në vetvete 2 nënçështje.

Nënçështja e parë ka të bëjë me caktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit \_\_\_\_ (që mbetet të caktohet) për gjykimin e një çështjeje gjyqësore në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.



Lidhur me këtë është përcjellë edhe relacioni shpjegues si vijon:

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me aktin nr. {...} prot., datë 03.12.2021, është regjistruar kërkesa e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, dërguar me shkresën nr. {...}, prot., datë 02.12.2021, përmes së cilës kërkohet caktimi i një gjyqtari, kundër të pandehurve: {...}, etj., bazuar kjo kërkesë në nenin 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e Këshillit nr.30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sipas nenin 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, “1. Në rastin kur në skemën e delegimit nuk ka magjistrat të disponueshëm dhe transferimi i përkohshëm i magjistratëve është i padobishëm për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor, Këshillat mund të caktojnë një magjistrat për gjykimin ose hetimin e çështjeve të veçanta në një gjykatë ose prokurori të ndryshme nga ajo ku ai ushtron funksionin në mënyrë të përhershme në rastet e mëposhtme: a) kur nuk ka një numër të mjaftueshëm gjyqtarësh; ose b) kur gjyqtarët e një gjykate ose prokurorie janë ligjërisht të padisponueshëm për gjykimin ose hetimin e një apo disa çështjeve”.

Ndërsa sipas preambulës së Vendimit të Këshillit nr.30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, rregullat sipas këtij vendimi janë të zbatueshme vetëm “në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’ju përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave”.

Aktualisht, në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshilli shërbejnë katërmbëdhjetë gjyqtarë, të cilët, për shkak të nevojave emergjente, janë caktuar në pesë gjykata të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, në një gjykatë të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrativ, si dhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Nga gjyqtarët e skemës së delegimit, gjashtë prej tyre, konkretisht gjyqtarët {...} - {...}, kanë kandiduar për ngritjen në detyrë në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe

krimin e organizuar, ku në kuadër të kandidimeve ata dhe familjarët e afërt të tyre kanë plotësuar dhe dorëzuar rregullisht formularët e vetëdeklarimit për dhënien e pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Gjyqtarët e tjerë të skemës së delegimit nuk kanë dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas këtij ligji.

Ndërkohë, nga gjyqtarët e skemës së delegimit që plotësojnë kushtet shtesë të sigurisë, tre prej tyre, konkretisht gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}, ndërsa plotësojnë kriteret për t’u caktuar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nuk i plotësojnë ato sa i përket caktimit në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pikërisht të kriterit të përvojës minimale profesionale sipas shkronjës “b”, pika 2, të nenit 47, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nga ana tjetër, tre gjyqtarët e tjerë të skemës së delegimit që plotësojnë kushtet shtesë të sigurisë, pra gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}, rezultojnë të plotësojnë kriteret për t’u caktuar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, verifikuar kjo në kuadër të procedurës së verifikimit sa i përket kandidimeve të tyre për ngritjen në detyrë në këtë gjykatë.

Në kushtet kur në listën e gjyqtarëve të skemës së delegimit janë tre gjyqtarë që plotësojnë kushtet dhe kriteret për t’u caktuar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, atëherë për plotësimin e nevojave në rastet konkrete në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pra për caktimin e një gjyqtari në atë çështje, është i nevojshëm organizimi i shortit midis këtyre tre gjyqtarëve, sikurse parashikohet në nenin 13, të Rregullores për Kriteret dhe Procedurën e Funksionimit të Skemës së Delegimit të Gjyqtarit, miratuar me Vendimin e Këshillit nr.22, datë 07.02.2019.

Në vijim, duhet të përmendur se në kërkesën e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk evidentohet pasja pengesë ligjore për gjykimin e çështjes për tre gjyqtarët si më sipër të skemës së delegimit që plotësojnë kushtet dhe kriteret për t’u caktuar në këtë gjykatë.

Ndaj sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin që është propozuar për miratim.

Projektvendimi i propozuar është i strukturuar në 2 pika.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet se gjyqtari i skemës së delegimit z./znj. \_\_\_\_\_ (gjyqtari që do të përzgjidhet nga shorti) caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogarit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 259-25, 188/2-25, 188/2, 245/1-25, 244 të Kodit Penal” (çështja për të cilën gjykata paraqet nevojë).

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit sipas pikës 1, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi, konkretisht menjëherë dhe publikimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

*(Në këtë moment të relatimit shkëputet energjia elektrike në disa pjesë të ambienteve të Këshillit, ndaj nuk janë në linjë znj. Llagami, znj. Shehu dhe z. Muharremaj. Në pamundësi për t’u rilidhur me platformën “online” Kryetarja e Këshillit, vijohet me trajtimin e çështjes nën drejtimin e z. Ooku.)*

*(Anëtarët prezent të Këshillit nuk kanë kundërshtime, ndaj propozimet e Komisionit konsiderohen të miratuara. Vijohet me procedurën e shortit.)*

Për çështjen me nr.46, përzgjidhet gjyqtari {...}.

Hidhet në votim projektvendimi:

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Medi Bici:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Alban Toro:** Dakord.

**Maksim Qoku:** Dakord.

Këshilli vendosi: 1. Gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} caktohet për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 259-25, 188/2-25, 188/2, 245/1-25, 244 të Kodit Penal”.

2. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Vijohet me nënçështjen e dytë dhe të fundit e cila ka të bëjë me projektvendimin “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”. Janë përgatitur relacionet e 7 gjykatave që kanë paraqitur nevojë për caktim gjyqtarësh.

Fillimisht zoti Toska relaton shkurtimisht relacionin sa i përket radhës së shortit duke i propozuar Këshillit që procedurat e shortit të ndiqen sipas kësaj radhe:

- A. Gjykatat e shkallës së parë, sipas kësaj radhe:
  - I. Gjykatat e shkallës së parë sipas juridiksioneve të gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm:
    - 1. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Korçë:
      - a. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec.
    - 2. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkodër:
      - a. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë.
    - 3. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Tiranë:
      - a. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë.
  - II. Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit administrativ:
    - a. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë.
- B. Gjykatat e apeleve, sipas kësaj radhe:

- I. Gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm:
  1. Gjykata e Apelit Gjirokastrë;
  2. Gjykata e Apelit Korçë;
  3. Gjykata e Apelit Shkodër.

Pasi anëtarët janë dakord me radhën e shortit, vijohet me relatimin e relacionit të parë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen, të jetë 3.

Propozimet vijues i Komisionit është:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti Kryetarja në detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, konkretisht: Znj. Luljeta Kole.

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë që nuk ushtron përkohësisht funksionin për arsye shëndetësore, konkretisht: Znj. Thomaidha Roça.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Eglantina Mikani (relatore), Besnik Shehu dhe Arben Lera (anëtarë).

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë** ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore, dy në lëndë penale dhe një civile.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3.

Për 2 (dy) çështje, ato nr.1 dhe nr.3, për të cilat kërkohet nga 1 (një) gjyqtar, të caktohen 2 (dy) të tillë, të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

Për 1 (një) çështje, atë nr. 2, për të cilën kërkohet 1 (një) gjyqtar, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Propozimet vijues i Komisionit është:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohen nga shorti Kryetarët në detyrë të Gjykatave të Rrethit Gjyqësor Kukës dhe Shkodër, konkretisht: Znj. Alma Ahmeti; Z. Arbër Çelaj

Në shortimin e çështjes nr. 2 të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që është caktuar më pare për gjykimin e saj, konkretisht: Z. Hasan Selimi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Sami Ujkashi.

Për çështjen nr. 3, civile, gjyqtari Florin Demollari.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Sokol Shehu.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tretë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2 (dy).

Për 1 (një) çështje, atë nr. 1, për të cilën kërkohet 1 (një) gjyqtar, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

Për 1 (një) çështje, atë nr. 2, për të cilën kërkohet 1 (një) gjyqtar, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Propozimet vijues i Komisionit është:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohen Kryetarët në detyrë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe Mat, konkretisht: Z. Ded Miri, Z. Artan Çupi.

Në shortimin e çështjes nr. 2 të përjashtohet gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, që nuk është përkohësisht në detyrë për arsye shëndetësore, konkretisht: Znj. Alda Sadiku.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe

kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Sula Lika.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Aurel Arapi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të katërt “Për caktim gjyqtari në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore.

Për nevojat si më lart të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 (një) çështje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, përfshirë dhe gjyqtarët e transferuar përkohësisht pranë saj.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 (një).

Propozimet vijues i Komisionit është:

Në shortimin e kësaj çështje të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, konkretisht: Z. Bevis Shehaj.

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga gjyqtari i transferuar përkohësisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, që është në përbërje të trupit gjykues që gjykon atë, konkretisht: Znj. Ema Shaholli.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, gjyqtar Hazbi Balliu.



Më pas vijohet me relatimin e relacionit të pestë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Gjirokastrë** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtarët që do të caktohet për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Korçë, përfshirë gjyqtarët e skemës së delegimit caktuar në këtë gjykatë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2 (dy).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e ngarkesës relativisht jo të lartë dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Korçë, të mos përjashtohet nga shorti Zëvendëskryetarja e kësaj gjykate, konkretisht: Znj. Arta Duka.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Sonjela Voskopi.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Dritan Hasani.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të gjashtë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Korçë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Korçë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Korçë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 2 (dy).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht: Z. Ridvan Hado.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Elbana Lluri dhe Genti Shala.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të fundit “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Shkodër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Shkodër** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Shkodër, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të

veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do të caktohet për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Durrës, përfshirë edhe gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë kësaj gjykate.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 (një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Durrës, konkretisht: Z. Valbon Çekrezi.

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, të cilët kanë pengesë ligjore ose janë caktuar më herët për gjykimin e saj, konkretisht: Znj. Irida Kacerja; Z. Florjan Kalaja.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Anita Mici.

Me kaq mbyllet procedurat e shortit dhe në tërësi e gjithë mbledhja plenare.

\* \* \*

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**